

19 Nëntor 2013

Dita Botërore për Parandalimin e Abuzimit ndaj Fëmijëve

Dhuna ndaj fëmijëve, një problem madhor i shëndetit publik kudo në botë, dhe me pasoja të rënda për gjatë gjithë jetës së fëmijëve të dhunuar, është një dukuri e parandalueshme. Por, për këtë është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi i gjithësecilit dhe i shoqërisë si e tërë. Ndaj kjo datë është përcaktuar botërisht për të rritur ndërgjegjësimin e individëve, komuniteteve, shoqërisë dhe strukturave shtetërore për të parandaluar dhe ndaluar këtë fenomen.

Prevalenca e dhunës ndaj fëmijëve

Ndonëse në Shqipëri rastet e dhunimit të fëmijëve janë ende pak të raportuara, studimet e kryera në këtë fushë kanë treguar për një prevalencë të lartë të këtij fenomeni.

Kështu, sipas një studimi të realizuar nga UNICEF në vitin 2006, pjesa më e madhe e të rriturve besonin se dhuna fizike dhe psikologjike ka efekte pozitive në edukimin e fëmijëve edhe pse ishin gjithashtu të ndërgjegjshëm për pasojat negative të saj.

Sipas të dhënave të studimit, format më të përhapura të dhunës psikologjike kundrejt fëmijëve në shtëpi ishin: *të bërtiturat* (95.3%), *fyerjet* (39.5 %), *kërcënimet* (39.0 %), *përdorimi i epiteteve denigruese dhe nofkave* (35.8 %), *kanosje me një objekt* (18.0 %). Ndërsa format kryesore të dhunës fizike të raportuara nga fëmijet në shkollë/ shtëpi përgjatë vitit të fundit ishin: *tërheqje e veshit* (60.1%/38.5%), *pickimi* (55.7%/36.9%), *goditja me një objekt* (53.0%/51.8%), *gjuajtja me shpullë (në fytyrë dhe në trup)* (52.6%/34.3%), *në kokë* (49.2%/35.6%), *shkulje flokësh* (41%/29.7%), *tërheqje me forcë dhe shtyrje* (34.6%/39.1%); *goditje me shkelma* (26.8%/25.8 %).

Studimi i OBSH i vitit 2012 mbi ‘Përvojat negative gjatë fëmijërisë të të rinjve Shqiptarë’ gjeti se: Prevalenca e përgjithshme e dhunës fizike dhe seksuale gjatë 18 viteve të para të jetës ishte respektivisht 41.5% dhe 6%. Rreth 30% e studentëve të intervistuar raportuan se gjatë fëmijërisë kanë qenë dëshmitarë të dhunës së ushtruar ndaj nënës së tyre. Rreth 40% e tyre kanë qenë ngacmuar nga shokët dhe janë përfshirë në konflikte fizike gjatë fëmijërisë.

Kuadri ligjor kundër dhunës ndaj fëmijëve

Shqipëria është një nga të 33 vendet që e ka plotësisht të ndaluar ndëshkimin fizik në kuadrin e saj ligjor. Ligji Nr. 10 347 *Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve* u miratua në 4 Nëntor të vitit 2010 dhe hyri në fuqi në Maj të vitit 2011. Sipas këtij ligji, ndëshkimi trupor i fëmijëve konsiderohet veprim i jashtëligjshëm edhe kur ushtrohet nga prindërit brenda familjes.

Përkufizimi i Abuzimit të fëmijëve

Në 1999, Këshillimi për Parandalimin e Abuzimit me Fëmijët, i OBSH-së dha këtë përkufizim:

“Abuzim apo keqtrajtim i fëmijëve janë të gjitha forma e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimit seksual, lënies pas dore dhe trajtimit me neglizhencë, trajtimit për qëllime komerciale apo çdo lloj tjetër shfrytëzimi, që rezulton me dëmtime reale, apo kërcënim ndaj shëndetit, mirëqenies, zhvillimit, ose dinjitetit të fëmijës, në kuadrin e marrëdhënieve të përgjegjësisë, besimit dhe pushtetit.”

Fëmijët mund të keqtrajtohen duke mos iu dhënë gjërat esenciale për të cilat ata kanë nevojë (neglizhimi) ose duke u bërë atyre gjëra dëmtuese (abuzimi). Neglizhimi ka të bëjë me mosplotësimin e nevojave të fëmijës: fizike, mjekësore, edukuese dhe emocionale. Neglizhimi emocional është pjesë e abuzimit emocional. Abuzimi mund të jetë fizik, seksual dhe emocional. Format e ndryshme të abuzimit ndodhin shpeshherë së bashku. Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve ndodhin shpeshherë së bashku me forma të tjera dhune si p.sh. dhuna ndaj partnerëve intim.

Abuzimet fizike lidhen me lëndimet fizike apo trupore, ose potencialisht të tilla, të shkaktuara fëmijëve nga kujdestarët e tyre.

Abuzimet seksuale përcaktohen si akte ku fëmija përdoret për të përmbushur kënaqësinë seksuale të kujdestarit.

Abuzimet emocionale lidhen me dështimin e kujdestareve për të krijuar një mjedis mbështetës dhe përmbledhin veprime si kufizimi i lëvizjes, denigrimi, talljet, kërcënimet dhe kanosjet, diskriminimet dhe forma të tjera të refuzimit jo fizik.

Trajtimi neglizhent dhe moskokëçares lidhet me dështimin e kujdestarëve për të krijuar një mjedis mbështetës për fëmijët, edhe pse prindërit janë në gjendje për ta krijuar atë dhe përfshin sferat e shëndetit, edukimit, zhvillimit emocional, ushqimit, strehimit dhe kushteve të sigurta të jetesës. Format kryesore të neglizhimit fizik kanë të bëjnë me mosplotësimin e nevojave esenciale të fëmijës për ushqim, veshje, strehë. Por ka edhe forma të tjera të neglizhimit. Prindërit mund të mos marrin masa parandaluese për shëndetin e fëmijës si p.sh. nuk kryejnë vaksinimin e fëmijës, kontrollin tek mjeku, apo dentisti. Prindërit mund të vonojnë marrjen e mjekimit për fëmijën kur ai është sëmurë duke rrezikuar kështu që fëmija të marrë sëmundje edhe më të rënda që mund të rezultojnë deri në vdekje. Prindërit nuk interesohen që fëmija të shkojë në shkollë; e lënë fëmijën në kujdesin e një personi që dihet se është abuziv, ose mund ta lënë fëmijën vetëm.

Pasojat e dhunës në shëndetin dhe jetën e fëmijës

Pasojat në shëndetin fizik:

- Dëmtime të vogla (djegie, prerje)
- Dëmtime të mëdha (kocka të thyera, hemorragji, deri edhe vdekje.)
- Dëmtim i zhvillimit të trurit. Abuzimi dhe neglizhimi është parë se në disa raste ka shkaktuar që zona të caktuara në tru të mos formohen apo rriten siç duhet duke rezultuar

në një dëmtim të zhvillimit, dhe duke patur pasoja në fushën mendore, gjuhësore dhe aftësitë akademike.

- Shëndet jo të mirë fizik. Të rriturit që kanë përjetuar abuzim ose neglizhim gjatë fëmijërisë kanë më shumë mundësi të vuajnë nga probleme fizike si: alergji, artrite, astma, bronkite, hipertension dhe ulçera.

Pasojat psikologjike:

Efektet emocionale imediate të abuzimit dhe neglizhimit, izolimi, frika dhe paaftësia për të besuar, mund të shndërrohen në pasoja për gjatë gjithë jetës që përfshijnë vetëvlerësimin e ulët, depresionin dhe vështirësitë në marrëdhënie. Kërkimet kanë treguar për lidhje ndërmjet abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve dhe:

- Vështirësive gjatë fëmijërisë. Depresioni dhe simptomat e tërheqies ishin të zakonshme ndërmjet fëmijëve 3 vjeçarë të neglizhuar.
- Shëndet jo të mirë mendor dhe emocional. Në një studim afatgjatë, 80% e të rriturve të rinj që kishin qenë të abuzuar në fëmijëri plotësonin kriteret për të paktën 1 çrregullim psikiatrik në moshën 21 vjeçare. Këta të rinj shfaqnin shumë probleme që përfshinin: depresionin, ankthin, çrregullimet në të ngrënë dhe tentativa për vetëvrasje.
- Vështirësi mendore. Fëmijët e abuzuar dhe neglizhuar tentonin të kishin pikë më të ulta krahasuar me popullatën e përgjithshme në matjet për kapacitetin mendor, zhvillimin gjuhësor dhe arritjet akademike.
- Vështirësi sociale. Fëmijët që përjetojnë neglizhim ose refuzim kanë më shumë mundësi të zhvillojnë tipare antisociale ndërsa rriten. Neglizhimi prindëror shoqërohet gjithashtu me çrregullime të personalitetit borderline dhe sjellje të dhunshme.

Duke patur nivel më të ulët arsimor për arsye të pengesave në aftësitë njohëse ose të shanseve të humbura në arsim, duke patur socializim të çrregullt dhe vështirësi emocionale, ata mund të kenë më pak shanse punësimi dhe pozicione më të ulta, ose më tepër vështirësi për të formuar marrëdhënie të shëndosha dhe afatgjata. Në këtë mënyrë ata mund të vazhdojnë të jenë të paprivilegjuar dhe të cënueshëm ndaj dhunës së mëtejshme.

Pasojat në sjellje:

Jo të gjithë fëmijët e abuzuar do të shfaqin probleme në sjellje, por problemet e sjelljes janë më të shpeshta në këtë grup individësh që në moshë të re. Në jetën e mëvonshme abuzimi dhe neglizhimi gjatë fëmijërisë duket se rrit mundësinë për probleme në sjellje. Studimet tregojnë se fëmijët e abuzuar dhe neglizhuar kanë së paku 25% më shumë mundësi për të patur probleme të tilla si kriminalitet, shtatëzani gjatë adoleshencës, arritje të ulta akademike, përdorim droge, angazhime në sjellje seksuale me risk, etj. Është vlerësuar se rreth 1/3 e fëmijëve të abuzuar dhe neglizhuar do të viktimizojnë fëmijët e tyre.